



MOS RIPARO ATË QË FUNKSIONON – II

Dokument pozicionues për
Pensionet në Kosovë



Shënim



Ky publikim u realizua me mbështetjen e Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e Iniciativës Kosovare për Stabilitet dhe aksesit nuk pasqyron qëndrimet e Bashkimit Europian.

Të gjitha të drejtat e rezervuara ©

qershor, 2016

Pasqyrë e përmbajtjes

Dokumenti i arsyeshmërisë	1
Pasqyrë e historisë së zhvillimit të sistemit pensional në Kosovë	1
Kornizat aktuale ligjore të sistemeve pensionale	2
Vështrim mbi situatën aktuale përbrenda publikut të shënjestruar ...	9
Vlerësimi i procesit	11
Vlerësimi i përmbajtjes	11
Përfundimet dhe rekomandimet: Rruga përpara	15



Dokumenti i arsyeshmërisë

Në prill/maj të vitit 2016, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nisi procesin e amendamentimit të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti¹. Hartimi i këtij konceptdokumenti kërkonte ta arsyetonte domosdoshmërinë për ndryshime të politikave, derisa analiza e opsioneve politike për t'i adresuar objektivat politike u zhvillua në mënyrë diskrete dhe nuk u diskutua si duhet me hisedarët relevantë. Këshilli Ekonomik Social, që është organi përgjegjës për ndërmjetësimin e dialogut social, asnjëherë as që ka diskutuar qoftë për domosdoshmërinë e ndryshimit të ligjit aktual qoftë për opsionet politike në dispozicion për t'i adresuar sfidat e politikave ekzistuese. Përveç mangësive procedurale dhe teknike (të lidhura me procesin), përmbajtja e ndryshimeve të propozuara ligjore gjithashtu ishte problematike dhe disa dispozita shkelin të drejtat themelore dhe mund të konsiderohen të jashtëligjshme dhe antikushtetuese.

Pasqyrë e historisë së zhvillimit të sistemit pensional në Kosovë

Para konfliktit të armatosur të vitit 1999, Kosova ishte pjesë e sistemit pensional të ish-Jugosllavisë, i cili bazohej në parimin e sigurimit pensional dhe të paaftësisë. Në këtë sistem pensional 'të parapaguar', kontributet e punëtorëve aktualë në fondin pensional shfrytëzoheshin për t'i paguar beneficionet e pensionistëve aktualë, duke lidhur kësisoji brezat e ndryshëm. Lartësia e pensioneve caktohej në bazë të përvojës së punës dhe lartësisë së të hyrave.² Para vitit 1989, Kosova kishte një fond pensional autonom i cili grumbullonte kontribute dhe paguante beneficione deri te shpërbërja e tij. Në po këtë periudhë, punëtorët kosovarë u përjashtuan nga sistemi dhe u larguan nga puna në mënyrë masive. Me të nisur konflikti, Beogradi i ndërpreu pagesat e pensioneve për kontributpaguesit e dikurshëm, të cilët e

¹Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9517>.

²<http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf>

kishin fituar këtë të drejtë përmes punës. Pas konfliktit u krijua një sistem urgjent i ndihmës, mirëpo pensionistët nuk u trajtuan me urgjencë. Duke pasur parasysh nevojën e popullatës për një sistem pensional, në vitin 2001, dy vjet pas përfundimit të konfliktit, donatorët ndërmorën veprime dhe siguruan udhëheqësi thelbësore duke e nxitur UNMIK-un të përzgjedhte një model pensional i cili do të ishte i përshtatshëm në afat të gjatë. Hartimin e politikave pensionale e udhëhoqën konsulentët të mbështetur nga USAID-i, me përfshirjen e përfaqësuesve nga UNMIK-u, BE-ja, FMN-ja, Banka Botërore, DFID-ja, dhe ILO-ja³. Prania civile ndërkombëtare përmes administratës së UNMIK-ut nisi një program të ndihmës sociale i cili përfshinte pagesat për kategoritë e caktuara të të moshuarve në bazë të vlerësimit të nevojave. Këto pagesa megjithatë mbuluan vetëm një pjesë të popullsisë së moshuar, dhe u panë më shumë si ndihmë sociale sesa si beneficione pensionale.

Deri më 2003 u përzgjedh modeli pensional, derisa sistemi i ri trishtyllësh u nda nga sistemi i bazuar edhe në solidaritetin linear edhe në atë vertikal (solidariteti/rishpërndarja ndërmjet pensionistëve dhe solidariteti ndërmjet brezave) drejt një sistemi kursimesh personale të definuar mirë. Sistemi i ri u krijua në tri shtylla, gjegjësisht përbëhej nga pensioni bazik fiks, skema e detyrueshme e kursimeve pensionale dhe skema vullnetare e kursimeve pensionale për kompanitë apo punëtorët.

Rregullorja e UNMIK-ut e Pensioneve të Kosovës Nr. 2001/35 që siguroi bazë ligjore për Shtyllën II dhe III — ishte akti i pari i cili po i rregullonte politikat pensionale në Kosovë që nga viti 1999. Rregullorja Nr. 2002/1510 vendosi bazën ligjore për Shtyllën I në mënyrë që të tri komponentët e sistemit të ishin operativë deri në vitin 2002. Në prill të po atij viti, Kuvendi miratoi Ligjin Nr. 2011/04-L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i cili e shfuqizoi Rregulloren Nr. 2005/20 dhe Ligjin Nr. 03/L-08411.

Kornizat aktuale ligjore të sistemeve pensionale

³ <http://legalpoliticalstudies.org/doi%20Report%2006%202012%20eng.pdf>

Ligji Nr. 04 / L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti⁴ është ligji i cili aktualisht i rregullon beneficionet dhe fushëveprimin e Skemës Bazike Pensionale në Kosovë, e cila përbën Shtyllën I të Sistemit Pensional. Ai është i plotësuar me Ligjin Nr. 2011/04-L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës⁵ si dhe me Ligjin Nr. 2012/04-L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04-L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.

Shtylla I - Pensionet Bazike

Ky pension është linear dhe aplikohet për të gjithë personat mbi moshën 65-vjeçare që rëndom banojnë në Kosovë. Ky pension i jepet secilit që e përmbush kriterin e moshës dhe nuk lidhet me punë. Beneficioni mujor nga kjo skemë pensionale në vitin 2002 ishte 28 euro, në vitin 2003 u rrit në 35 euro, dhe mbeti 40 euro prej vitit 2004 deri në vitin 2008. Që nga prilli i vitit 2014, ky pension është 75 euro. Në shtator të vitit 2015 ishin 130.320 persona të cilët ishin përfitues të Pensioneve Bazike.⁶

Administrata Pensionale e Kosovës (APK) është përgjegjëse për administrimin e këtij pensioni përmes transfereve mujore të parave. Shuma e pensionit bazik shpërndahet për person dhe lartësia e saj vendoset çdo vit, në vazh të nevojave minimale të konsumit sipas shportës mujore të konsumit⁷. Çdo shumë më e ulët se kjo do t'i përballte pensionistët me rrezikun nga varfëria. Tabela në vijim tregon se si pensioni bazik mujor ka pësuar ndryshime që nga fillimi (2002) deri në vitin 2015, duke përfshirë edhe projeksionet qeveritare për periudhën 2016-2018.

Tabela tregon se shumta mujore (në euro) që iu shpërnda pensionistëve çdo muaj gjatë viteve 2011-2013 bazohej në shportën minimale të konsumit (62 euro në vitin 2012). Përderisa ka edhe gjëra të tjera përveç shportës së artikujve, personi i cili jeton vetëm me pensionin bazik ka shumë gjasa të

⁴ <http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2010/09/Law-No.-04-L-101.pdf>

⁵Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 2011/04-L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2815>.

⁶Agjencia Statistike e Kosovës

⁷World Bank, The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons , 2007, at: <http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf> and Group for Legal and Political Studies, Pension System in Kosovo, p. 7.

përballet me vështirësi për të jetuar i pavarur dhe prandaj do t'i duhet të mbështetet në anëtarët e familjes⁸.

Tabela 1 – Pensionet Bazike Mujore 2002-2018

Viti	Numri i përfituesve	Norma mujore	Buxheti vjetor i ndarë për pensionet bazike
2002	93.087	28 €	17,874,763.00
2003	108.279	35 €	44,459,960.00
2004	116.932	40 €	54,193,599.00
2005	124.893	40 €	59,133,333.00
2006	127.356	40 €	63,766,380.00
2007	131,874	40 €	63,133,100.00
2008	138.847	40 €	65,641,485.00
2009	130,347	45 €	73,603,960.00
2010	109,585	45 €	63,640,920.00
2011	107.145	45 €	61,196,210.00
2012	113.043	50 €	73,983,888.00
2013	117.042	60 €	82,388,924.00
2014	122.363	75 €	89,836,507.00
2015	130.320	74 €	119,083,713.00
2016	n/a	74 €	123,480,000.00
2017	n/a	74 €	134,602,500.00
2018	n/a	74 €	128,955,000.00

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Buxheti Vjetor i Republikës së Kosovës

Për ata të cilët kanë paguar kontribute në sistemit pensional të Republikës së Serbisë para konfliktit, që nga viti 2008 u aplikua pensioni shtesë për pensionistët. Pensioni mujor u fiksua në 35 euro, dhe do t'i shtohet pensionit

⁸ Budgeting for Social Welfare - A Gender+ Analysis to Inform Gender Responsive Budgeting in the Ministry of Labour and Social Welfare in Kosovo for 2016-2018

bazik të moshës nëse evidentohen së paku 15 vite pagese kontributi në sistemin e kaluar. Sipas Departamentit të Pensioneve (DP), më se 28,135 pensionistë — apo rreth 20% të të gjithë pensionistëve mbi 65 vjeç — marrin pensione që nga janari i vitit 2009. Ky numër pritet të rritet në të ardhmen.

Shtylla 2 - Kursimet pensionale individuale (të detyrueshme)

Sistemi i kursimeve pensionale të detyrueshme siguron pensione të cilat e plotësojnë pensionin bazik, që i mbulon të punësuarit dhe personat e tjerë mbi moshën 18-vjeçare të cilët janë ekonomikisht aktivë. Ky kursim është i detyrueshëm për personat e lindur pas vitit 1946, derisa për të lindurit para këtij viti kontributi është lënë në baza vullnetare. Çdo punëdhënës është i obliguar t'i mbajë kontributet e kursimeve pensionale për të punësuarit e vet në shumën prej 10% të pagës bruto, e cila ndahet ndërmjet punëdhënësit (5% e pagës bruto) dhe të punësuarit (5% e pagës bruto) — edhe pse ekziston mundësia e pagesës deri në 15% (Shtylla e Pensioneve Vullnetare III). Regjistrat e këtyre transaksioneve menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), i cili këto fonde pastaj i investon jashtë vendit në bursa të mëdha europiane. Fondet jashtë vendit dhe investimet vendore nuk janë nën juridiksionin ligjor; megjithatë, ekzistojnë standardet e larta të sigurisë. Në total, asetet e TKPK-së ishin mbi 100 milionë euro në fillim të vitit 2005 dhe arritën vlerën 200 milionë euro në fund të vitit 2006. Këto asetet janë të centralizuara për t'i minimizuar kostot administrative. Niveli i pensionit dhe metoda varet nga shuma e asetëve të grumbulluara. Tabela 2 paraqet shpenzimet e planifikuara për pensionet kontributpaguese për vitin 2016 dhe 2017 duke u bazuar në buxhetin vjetor të Republikës së Kosovës⁹.

⁹Ligjet për Buxhetin e Kosovës ndër vite:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20Buxhetin%20e%20Kosoves%202014.pdf>

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-001%20sh.pdf>

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Buxheti%202012.pdf>

<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/04-L-165%20PL%20per%20buxhetin%202013.pdf>

Tabela 2 –Shpenzimet aktuale dhe të planifikuara për pensionet kontributpaguese

Viti	Subvencionet dhe transferet
2013	€47,897,475.00
2014	€47,897,475.00
2015	€68,633,800.00
2016	€68,946,380.00
2017	€70,022,499.00

Tabela 3 paraqet pensionin kontributpagues vjetor për person në euro. Çdo vit, këto pensione kontributpaguese kanë pasur rritje. Shuma planifikohet të rritet për një euro çdo vit në periudhën 2016-2018.

Viti	Tabela 3 – Pensioni vjetor për person në euro
2013	1,372
2014	1,601
2015	1,690
2016	1,659
2017	1,660
2018	1,661

Shtylla 3 - Sistemi Pensional Vullnetar

Sistemi pensional vullnetar është i organizuar në nivel të ndërmarrjes si fond pensional shtesë i punëdhënësit apo në baza individuale si fond pensional individual shtesë. Banka Qendrore e Kosovës i rregullon dhe i mbikëqyrë

ndërmarrjet private të cilat ofrojnë sigurim të pensionit vullnetar. Tabela në vijim paraqet karakteristikat e çdo shtylle¹⁰:

	Shtylla I Pensionet bazike	Shtylla II Pensionet e kursimeve individuale	Shtylla III Pensionet vullnetare individuale apo të punëdhënësit Vullnetare
Pjesëmarrja	Universale	E detyrueshme	Vullnetare
Kualifikueshmëria	Të gjithë qytetarët	Kontributpaguesit	Kontributet vullnetare
Norma e kontributit	n/a	5% punëdhënësi dhe 5% i punësuarit	Varet
Mbulueshmëria	Të gjithë banorët e rëndomtë, ose të moshës mbi 65-vjeçare ose 100% të paaftë	Implementimi me faza: Të gjithë banorët e rëndomtë, që punojnë	Në fillim shumë e kufizuar
Ofruesi	Administrata Pensionale e Kosovës	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës	Punëdhënësit, Fondet pensionale, Kompanitë e sigurimeve, Bankat
Organet regulluese	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Ekonomisë dhe e Financave	Autoriteti bankar dhe i pagesave i Kosovës (ABPK)	Autoriteti bankar dhe i pagesave i Kosovës (ABPK)
Investimet	n/a	Menaxherët profesionalë të aseteve	Menaxherët e licencuar të aseteve dhe Kompanitë e sigurimit

¹⁰World Bank, The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons , 2007, at: <http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf>.


Agjencioni i grumbullimit	n/a	Administrata tatimore	Punëdhënësit, Fondet pensionale, Kompanitë e sigurimeve, Bankat
----------------------------------	-----	-----------------------	---

Tabela e Bankës Botërore, Mbrojtja sociale

Vështrim mbi situatën aktuale përbrenda publikut të shënjestruar


Në vitin 2015, IKS-ja ka zhvilluar Anketën e perceptimeve dhe të qëndrimeve të qytetarëve ndaj standardit të jetesës dhe të mirëqenies¹¹ me 1,100 të anketuar. Një pjesë e kësaj ankete iu kushtua perceptimeve të qytetarëve ndaj ndihmës sociale, shërbimeve dhe sistemit të sigurisë sociale në Kosovë. Këto ishin disa prej përgjigjeve dhe këndvështrimeve të të anketuarve.

Qeveria ka përgjegjësinë të ofrojë standard të pranueshëm jetese për të moshuarit?




Kosovarët duket se janë të ndjeshëm ndaj të moshuarve. Anketuesit e intervistuar në masë të madhe besojnë se Qeveria është gjithashtu përgjegjëse për të siguruar standarde të pranueshme të jetës për të moshuarit. Derisa 84.5% prej tyre pajtohen fuqishëm se është përgjegjësi e Qeverisë t'u sigurojë të moshuarve standard të denjë të jetës, 9.5% prej tyre shprehen se më shumë pajtohen se që e kundërshtojnë një qëndrim të tillë. Vetëm gjysmë për qind prej tyre thonë se aspak nuk pajtohen apo më shumë nuk pajtohen se që pajtohen me këtë qëndrim.

11 KES Publikimet 'Standardi i jetesës dhe i mirëqenies' Raporti 2, 2015



Duke u nisur nga kjo, 65.9% e të anketuarve e vlerësojnë standardin e jetesës së pensionistëve 'shumë të keq', 16.2% e të anketuarve deklarojnë se standardi i jetesës së pensionistëve është 'i keq'. Qytetarët u pyetën edhe për nivelin minimal të pensionit bazik për t'i mbuluar nevojat elementare të pensionistëve. Në dritë të kësaj, 50% e të anketuarve këtë shumë e konsiderojnë prej 201 deri në 300 euro, derisa 21.5% prej tyre konsiderojnë së kjo shumë duhet të jetë prej 201 deri në 500 euro. Gati 24% e qytetarëve besojnë se pensioni bazik duhet të jetë ndërmjet 101 dhe 200 euro, derisa vetëm 4.6% e të anketuarve besojnë se vlera minimale e pensionit bazik duhet të jetë më e lartë se 500 euro.

Në cilën shkallë duhet të jetë pensioni bazik për t'i mbuluar nevojat themelore të pensionistëve?



Vlerësimi i procesit

Duke marrë parasysh se Ligji, temë e këtij dokumenti, dhe procesi i rishikimit prek secilin qytetar të Kosovës si të brezit ekzistues ashtu edhe, potencialisht, të brezave të ardhshëm, procesi i rishikimit/ndryshimit duhet të konsultohet gjerë e gjatë dhe nevojitet konsensus i opinionin publik për ndryshimet e nevojshme që duhen bërë. Procesi deri më tani ka qenë mjaft diskret, duke përfshirë fillimisht stafin e MPMS-së dhe konsulentët e jashtëm të angazhuar nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Si i tillë, procesi nuk mund të konsiderohet as përfshirës, as i hapur e transparent.

Për më tepër, fushëveprimi dhe aplikimi i ndryshimeve të propozuara të grupit punues për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit e ndryshon tërësisht skemën pensionale në Kosovë. Kjo e tejkalon 40-përqindëshin e ndryshimit që mund të bëhet përmes procesit të Ndryshimit dhe të Plotësimit. Ligjërisht, ndryshimet e propozuara mund të përfshihen vetëm përmes hartimit të një ligji të ri. Si i tillë, procesi i Ndryshimit dhe i Plotësimit të Ligjit është mjet joadekuat i planifikimit/ndryshimit të politikave për të sjellë ndryshime të sistemit pensional në Kosovë.

Mangësia e tretë në lidhje me procesin e arritjes/sajimit të ndryshimeve në sistemin pensional ekzistues është se objektiva politike e reformës së propozuar po ia heq barrën buxhetit publik pa i marrë në konsideratë objektivat politike të skemave ekzistuese dhe atyre të propozuara. Ndryshimet e propozuara nuk i marrin parasysh as specifikat e popullsisë së shënjestruar të prekur nga këto ndryshime (pensionistët), as rrezikun social të cilin sistemi pensional mëton ta adresojë, gjegjësisht rrezikun e pleqërisë.

Vlerësimi i përmbajtjes

Mbrojtja nga rreziku i pleqërisë gjithashtu parashihet nga Karta Sociale Europiane, e cila në Nenin 23 thotë: 'Çdo person i moshuar ka të drejtë për

mbrojtje sociale'.¹² Kushtetuta e Kosovës parasheh se të gjitha traktatet e mëdha që ndajnë vlerat universale të të drejtave janë të zbatueshme në Kosovë, duke përfshirë Kartën Sociale Europiane. Derisa Shtylla II përfaqësohet nga Skema e Kursimeve Pensionale që është e obligueshme dhe menaxhohet në mënyrë të pavarur dhe investohet nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, shteti krejtësisht heq dorë nga obligimi dhe mbrojtja e qytetarëve të vet. Për më tepër, Skema Individuale e Kursimeve nuk garantohet në asnjë mënyrë nga Qeveria, megjithëse i obligon qytetarët t'i derdhin kursimet e tyre të moshës në këtë skemë. Fondet mund të avullohen krejtësisht pa paralajmërim paraprak, nëse kolapsojnë tregjet financiare ku këto fonde investohen. Gjatë krizës së vitit 2011, investimet e Trustit të Kursimeve Pensionale pësuan humbje milionëshe, duke dëshmuar për pasigurinë e fondeve të investuara. Me heqjen e Shtyllës I të Pensionit Bazik të Moshës, dhe me Shtyllën II të Kursimeve Pensionale që varet nga performanca e tregut, pensionistët e Kosovës mbesin krejtësisht të pambrojtur, duke dështuar kështu të zbatohen garancionet sipas Kartës Sociale Europiane dhe dokumentet e konventat e tjera ndërkombëtare të hartuara në frymë të kësaj Karte.

Neni 1.4 i Ligjit, që është subjekt i ndryshimit, definon **Pensionin bazik të moshës** - pensioni i rregullt mujor i paguar për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që kanë mbushur moshën 65-vjeçare, e të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë Ligj.¹³ Pensioni bazik i moshës është i vetmi pension i cili u jepet në mënyrë universale vetëm qytetarëve rezidentë, duke ua ndaluar kështu të pensionuarve kosovarë të drejtën e mbrojtjes e cila garantohet nga kushtetuta dhe nga traktatet e dokumentet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë. Skema aktuale e moshës është skemë e qartë e mbrojtjes së moshës, që nuk ka të bëjë as me punë as me të ardhura. Kushtëzimi me të ardhura e shndërron këtë skemë në skemë të varfërisë, e cila kur analizohet nga këndvështrimi i kontributpaguesve aktivë në fuqinë punëtore, paraqet diskriminim. Atyre të cilët kanë kursyer për shkak të punës së tyre dhe kanë kursyer në trustin e kursimeve pensionale, u ndalohe

12 Karta Sociale Europiane (E rishikuar) 03. V. 1996. Gjetet në:
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000168007cf93>

¹³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9517>

pensioni i moshës, e i cili u garantohet me ligjin aktual. Ngjashëm me këtë, atyre të cilët kanë pasur mundësinë të posedojnë asete e beneficione kundrejt huazimit të atyre aseteve, u refuzohet e drejta e vetme të cilën e kanë në vendin e origjinës, duke u kushtëzuar me vendbanim.

Të gjitha kushtëzimet që propozohen sipas amendamenteve aktuale rrjedhimisht nuk janë as legale as të arsyetueshme për skemën pensionale të moshës, e cila është shtylla e parë e Skemës Pensionale të Kosovës. Përderisa një dozë kushtëzimi aplikohet edhe në skemat pensionale në vendet e tjera, t'i krahasosh ato me Kosovën nuk është e saktë dhe mund të çojë në keqkuptime të mëdha. Shtetet të cilat parashohin kushtëzime në të ardhura dhe në status social janë shtete të cilat kanë sisteme të sigurimit pensional. Në Kosovë, një nivel i tillë i mbrojtjes për pensionistët nuk ekziston. Sigurimi pensional zakonisht shfaqet në formë të një fondi pensional nacional, i cili aplikohet edhe në lidhjet horizontale të shpërndarjes edhe në lidhjet vertikale ndërmjet brezash (skemat PAYG). Në secilin rast, ato janë shumë më ndryshe se sistemi i kursimeve pensionale i shtyllës së dytë të sistemit të Kosovës, që përfshin llogari individuale të kursimit të cilat 'mbushen' privatisht, dhe për të cilat shteti nuk jep kontribute (përpos kur punohet për shtetin). Portofoli i investimeve i TKPK-së gjithashtu nuk garantohet nga Qeveria e Kosovës, dhe kështu e pamundëson edhe më shumë krahasueshmërinë e parimit të kushtëzimit ndërmjet Kosovës dhe vendeve të tjera. Ndryshimet e propozuara do të jenë vështirë të zbatueshme meqë duke marrë parasysh situatat e paparashikueshme që mund të ndodhin, mund të ketë pensionistë të cilët i shterrojnë kursimet e tyre shumë shpejt, apo ata të cilët nuk kanë kursyer mjaftueshëm, apo në rastet edhe më të këqija, bankrotimi i Trustit Pensional do t'i linte të gjithë të moshuarit pa mbrojtje.

Teksti i propozuar që u diskutua nga grupi punues për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti parasheh ndryshime të mëdha të sistemit pensional në Kosovë, të cilat tejkalojnë 40-përqindëshin e ndryshimit të përmbajtjes që lejohet në një proces të Ndryshimit dhe Plotësimit. Për sa i takon përzgjedhjes së fjalëve në këtë dokument, domethënia e këtij ndryshimi 'kozmetik' është se Shtylla I e Sistemit Pensional aktual hiqet krejtësisht. Kësisoj rreziku i moshës, i cili përkufizohet në Ligjin që është subjekt i ndryshimit, mbetet i pambuluar.

Përmes reformës së propozuar, parashihet skema e re e quajtur "Pensioni Social i Moshës", e cila ndryshe nga skema aktuale është një skemë e cila nuk adreson rrezikun e moshës, por vërfërinë e popullsisë së moshuar. Nëse merret vetëm ky ndryshim, ai paraqet ndryshimin e 1/3 të sistemit pensional të Kosovës apo tërë Shtyllën I të këtij sistemi, që kërkon një proces krejtësisht të ri dhe rimendim të politikave pensionale dhe adresim të sfidave të sistemit aktual. Kjo megjithatë nuk mund të realizohet pa konsultime të gjera dhe pa debat publik, pasi që ndikimi i kësaj politike nuk është vlerësuar fare. Popullsia e Kosovës është relativisht e re, dhe numri i përfituesve të pensionit bazik brenda sistemit përgjatë viteve ka mbetur thuajse i pandryshuar. Edhe pse parashihet se do të ketë rritje të popullsisë mbi moshën 65-vjeçare dhe rënie të natalitetit, situata prapëseprapë do të ishte e favorshme për sa i përket ruajtjes së një pensioni të përshtatshëm për kontributpaguesit e sistemit. Në një shtet si Kosova, ku plakja e popullsisë nuk është çështje, heqja e mbrojtjes nga pleqëria as nuk kërkohet as nuk i shërben përmirësimit të sistemit pensional dhe mbrojtjes nga rreziku i pleqërisë. Shkurtimi i periudhës së vizitave personale të pensionistëve nga 6 muaj (që aplikohet sot) është shkelje e të drejtave të tyre themelore dhe duhet të konsiderohet si shqetësim. Një kontroll i tillë nuk është praktikë në asnjërin prej skemave të financuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Rrjedhimisht, detyrimi i pensionistëve t'i vizitojnë Zyret e Administratës Pensionale është jonjerëzor dhe shprehje e qartë e shqetësimit dhe ngacmimit të pensionistëve.

Ky abuzim për më tepër vazhdon duke i detyruar të riaplikojnë nëse nuk e mbërrijnë regjistrimin në kohë dhe duhet t'i sjellin të gjitha certifikatat dhe dokumentacionin e nevojshëm, duke i shkelur edhe më tej të drejtat themelore të pensionistëve. Nëse pensionistët njëherë e kanë sjellë dokumentacionin dhe ai është në regjistrat e MPMS-së, detyrimi i tyre të reregjistrohen nga fillimi është shqetësim ndërkombëtar i cili ka për qëllim t'i dekurajojë që t'i kërkojnë të drejtat e tyre. Duke marrë parasysh se moshja e tretë shpesh lidhet me shëndet të përkeqësuar, pastaj me rrethanat dhe sëmundjet e përkohshme apo të përhershme të lidhura me moshën, procesi i përsëritur i aplikimit mund të konsiderohet si ngacmim i qëllimshëm për t'u ndërprerë beneficionet të cilat ata i gëzojnë. Nëse statusi i tyre ndërpritet për shkak të mosparaqitjes në zyret pensionale, paraqitja e tyre (pas çfarëdo periudhe që kjo mund të ndodhë) duhet të përbëhet vetëm nga ardhja e tyre me një dokument të vlefshëm identifikimi.

Derisa vendimmarrja dhe politikëbërja bashkëkohore kërkon politikëbërje të orientuar drejt qytetarit dhe qëndrim përgjigjës të Qeverisë, politika e propozuar nuk është adekuate nëse merret parasysh situata socioekonomike në Kosovë, dhe nuk merr parasysh nevojat dhe kontekstin specifik të popullsisë së shënjestruar të cilën ajo mëton ta adresojë. Ajo e dobëson edhe më tej sistemin tashmë të dobët të mbrojtjes sociale në Kosovë dhe e përkeqëson cilësinë e shërbimit për përfituesit. Ajo vetëm ka për qëllim ta zvogëlojë barrën e buxhetit, dhe si e tillë ajo ka sjellë pasoja serioze për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Po ashtu, gabimi i dytë më i madh sa i përket përmbajtjes shfaqet në pjesën e Ligjit i cili i trajton të ardhurat e fituara gjatë jetës si të ardhura aktuale gjatë kohës së tërheqjes së tyre nga TKPK-ja. Kursimet pensionale janë kursime personale të çdo personi të cilat janë fituar përgjatë pjesëmarrjes aktive në fuqinë punëtore, që për shumicën e njerëzve është mbi 40 vjet. Në moshën 65-vjeçare, pensionistët gëzojnë të drejtën t'i marrin kursimet e tyre, të cilat në rastin më të mirë mund të konsiderohen si varfërim i tyre meqë ata po i shterrin kursimet e tyre jetësore. Propozimi i tanishëm e konsideron kthimin e kursimeve pensionale si të ardhura të rregullta aktuale dhe e konsideron atë si bazë për largimin nga skema bazike pensionale. Sipas po këtij parimi (duke e konsideruar si të ardhura aktuale), pensioni tatohet, që përsëri paraqet shkelje flagrante të të drejtave të pensionistëve dhe përkeqësim të mëtejshëm të situatës tashmë të vështirë financiare.

Përfundimet dhe rekomandimet: Rruga përpara

Skemat pensionale janë mekanizma për zvogëlimin e rreziqeve nga varfëria në mesin e të moshuarve dhe ato sigurojnë të ardhura të qëndrueshme për t'i ruajtur standardet e jetesës gjatë periudhës së pensionimit. Andaj, politikat pensionale në fuqi ndikojnë në gjendjen ekonomike të të moshuarve. Ato ndikojnë në rrezikun e tyre nga varfëria dhe mospërfshirjen sociale gjatë periudhës së tyre të pensionimit. Duke u nisur nga fakti që plakja është proces i pakthyesëm, reforma e prek secilin qytetar të Kosovës i cili do të dalë në pension me kontribute të cilat i ka paguar pas vitit 2004. Ndryshimet e propozuara në kuadër të procesit aktual të Ndryshimit dhe Plotësimit e

tejkalojnë 40-përqindëshin maksimal të ndryshimeve të lejuara në një proces të tillë. Si të tilla, nëse ato miratohen, kjo do të përbente shkelje të parimit bazik ligjor mbi bazën e të cilit përcaktohet se ç'lloj procesi do ta ndjekë ndryshimi i një politike të caktuar.

Ndryshimet politike të propozuara përmes procesit të Ndryshimit dhe Plotësimit as nuk janë debatuar publikisht as nuk kanë përfshirë analiza të qenësishme të ndikimit, edhe pse reforma e prek secilin qytetar të Kosovës. Duke marrë parasysh përqindjen e popullsisë që e përfaqësojnë pensionistët në Kosovë (70% e qytetarëve janë nën moshën 35-vjeçare), nuk ka kurrfarë paze për të lëvizur tutje me një ndryshim aq të madh të politikave në një mënyrë aq të vrazhdë. Si i tillë, procesi aktual duhet të ndërpritet menjëherë. Nëse MPMS-ja dhe Qeveria e Kosovës konsiderojnë se ndryshimi i politikave është i domosdoshëm, atëherë duhet të formohet grupi punues për hartimin e Ligjit të ri të Skemave Pensionale të Financuara nga Shteti apo të inicohet një reformë gjithëpërfshirëse e Sistemit Pensional dhe të zhvillohet një proces i hapur dhe përfshirës. Palët e interesuara duhet të përfshihen në grupet punuese për të siguruar se sistemi i ri i adreson në mënyrë të duhur nevojat e popullsisë së cilës i shërben.

Procesi i reformave, nëse do të ketë një të tillë, duhet të synojë përmirësimin e shërbimeve/beneficioneve për të moshuarit, zvogëlimin e burokracisë administrative e cila ka të bëjë me përfitime nga skema pensionale e moshës, dhe shkarkimin e burimeve ministrore për të identifikuar dhe për të larguar keqpërdorues potencialë të skemës. Reforma nuk duhet ta ngarkojë pensionistin duke e detyruar të dëshmojë se është gjallë, por duhet ta sofistikojë sistemin që automatikisht t'i largojë të vdekurit nga skema. Në këtë drejtim, mund të mbështetet praktika e disa komunave për t'i detyruar bashkësitë fetare t'i raportojnë të gjitha varrimet, meqë kjo mundëson çregjistrim të menjëhershëm të të vdekurit nga lista e përfituesve të këtij beneficioni. Detyrimi i obligimit për t'i raportuar të gjitha varrimet është hap i detyrueshëm të cilin politikat e ardhshme duhet ta parashohin. Ky hap i vetëm do ta eliminonte nevojën e paraqitjes individuale të pensionistëve pranë zyrave të MPMS-së për të dëshmuar se janë gjallë.

Inicimi i një ndryshimi aq të madh të politikave pa ndonjë nevojë të menjëhershme, duke mos marrë parasysh rrethanat e grupit të shënjestruar dhe duke i sajuar politikat vetëm për t'ia hequr barrën buxhetit, është joadekuat dhe nuk duhet vazhduar në procesin e ardhshëm të reformave.

MPMS-ja është përgjegjëse të sigurohet se kategoritë më të cënueshme janë të mbrojtura dhe se ka sistem të shëndoshë social i cili është i sajuar për t'iu përgjigjur në mënyrë specifike nevojave të kategorive më të cënueshme (e që janë të gjithë të moshuarit). Ajo nuk mund të iniciojë procese të reformave të cilat synojnë përkeqësimin e mbrojtjes së qytetarëve të saj pa pasur krizë të madhe ekonomike. Kosova nuk ka përjetuar ndonjë krizë ekonomike, por ka treguar rritje të ngadaltë dhe të qëndrueshme edhe në kohën kur ekonomia globale nuk ka treguar rezultate të mira. Çdo përpjekje për t'i formuluar politikat pensionale me synim të zvogëlimit të shpenzimeve buxhetore dhe jo me qëllim të rritjes së mbrojtjes dhe gjithëpërfshirjes së sistemit, do të ketë efekte të pariparueshme për brezin aktual dhe për brezat e ardhshëm.

PËR NE

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është institut kërkimor i pavarur, jofitimprurës që fokusohet në hulumtime dhe analiza empirike të zhvillimeve socioekonomike në Kosovë. IKS-ja u themelua në vitin 2004 duke parë nevojën e madhe për analiza të pavarura e të thukta të çështjeve të rëndësishme që ndërlidhen me promovimin e stabilitetit dhe të prosperitetit në Kosovë. Hulumtimet e saj inovative dhe të orientuara drejt politikave kanë për qëllim të nxisin debate rreth çështjeve të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës

Ne besojmë se debatet publike të bazuara në argumente përbëjnë thelbin e vendimmarrjeve demokratike dhe të transformimit ekonomik të vendit. IKS-ja nuk ka përkatësi politike, partiake apo organizative të çfarëdo lloji.

Ekipi me përvojë të gjerë dhe shumëdimensionale i IKS-së është i përkushtuar ta arrijë synimin e vet. Bordi Këshillëdhënës me analistë e ekspertë vendorë e ndërkombëtarë gjithashtu mbështet punën e saj.

Që nga themelimi, IKS-ja ka zhvilluar një sërë projektesh hulumtimi empirik të përqendruara në çështjet siç është qeverisja, zhvillimi ekonomik, planifikimi urban, trashëgimia kulturore, korrupsioni në rindërtimin e pasluftës, çështjet e mjedisit, arsimit, problemi i imazhit të Kosovës si dhe struktura e tanishme e ngatërruar qeverisëse.

IKS-ja është pjesë e rrjetit të frymëzuar nga Iniciativa Europiane për Stabilitet, me shtrirje në mbarë Europën Juglindore dhe anëtare e asociuar e ECAS-së.

Të gjitha raportet mund të shkarkohen pa pagesë nga uebfaqja jonë.



**SUPPORT
TO SOCIAL
PARTNERS**





An EU funded project managed by the
European Union Office in Kosovo

